pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHËNIM: 1. Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

22. Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

- (a) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.
- (b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në

bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

- (c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;
- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta**MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme****N - Numri i ofertave të vlefshme****PR (Zm) – Zbritje e mundshme**

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS**23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;

- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtjesit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Studimi i Fizibilitetit për Infrastrukturën e Trafikut Ajror në Aeroportin e Kukësit

1. Referencat

- ICAO Dokumenti 4444 'Procedura për Shërbimet e Navigimit Ajror — Menaxhimi i Trafikut Ajror' (PANS-ATM), Botimi i Gjashtëmbëdhjetë, 2016, Amendamenti 11 i datës 3 Nëntor 2022.
- ICAO Dokumenti 9426, Manuali i Planifikimit të Shërbimeve të Trafikut Ajror, Pjesa III, Kapitulli 2, Kërkesat Specifike për një Kullë Kontrolli Aerodromi.
- ICAO Aneksi 11 'Shërbimet e Trafikut Ajror', Botimi i Pesëmbëdhjetë, Korrik 2020.
- ICAO Aneksi 14 'Aerodrome – Vëllimi I, Projektimi dhe Operacionet e Aerodromeve', Botimi i Nëntë, Korrik 2022.
- ICAO Dokumenti 9184, Manuali i Planifikimit të Aeroporteve - Pjesa I - Planifikimi Kryesor.
- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2017/373 e datës 1 Mars 2017 që përcakton kërkesat e përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/shërbimeve të navigimit ajror dhe funksioneve të tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre, duke shfuqizuar Rregulloren (KE) Nr. 482/2008, Rregulloret Zbatuese (BE) Nr. 1034/2011, (BE) Nr. 1035/2011 dhe (BE) 2016/1377 dhe duke ndryshuar Rregulloren (BE) Nr. 677/2011.
- Rregullorja (BE) 2018/1139 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 4 Korrik 2018 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe për krijimin e Agjencisë së Sigurisë së Aviacionit të Bashkimit Evropian, duke ndryshuar Rregulloret (KE) Nr. 2111/2005, (KE) Nr. 1008/2008, (BE) Nr. 996/2010, (BE) Nr. 376/2014 dhe Direktivën 2014/30/BE dhe 2014/53/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, dhe duke shfuqizuar Rregulloret (KE) Nr. 552/2004 dhe (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregulloren e Këshillit (KEE) Nr. 3922/91.
- Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) Nr. 923/2012 e datës 26 Shtator 2012 që përcakton rregullat e përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në navigimin ajror dhe që ndryshon Rregulloren Zbatuese (BE) Nr. 1035/2011 dhe Rregulloret (KE) Nr. 1265/2007, (KE) Nr. 1794/2006, (KE) Nr. 730/2006, (KE) Nr. 1033/2006 dhe (BE) Nr. 255/2010.
- Rregullorja e Komisionit (BE) Nr. 139/2014 e datës 12 Shkurt 2014 që përcakton kërkesat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet në përputhje me Rregulloren (KE) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.
- Materiali Udhëzues i EASA-s për shërbimet ajrore të trafikut të aerodromeve të largëta – Botimi 3 – 30 Mars 2023.
- Udhëzuesi i Dizajnit të Kullës së Kontrollit të Trafikut të Aeroportit dhe Qendrës së Radarit të Terminalit nga FAA.
- Koncepti i Operimit të Sistemeve të Kullës së Largët nga FAA, Versioni 1.0, Prill 2020.
- Studimi i NACO-s mbi Aeroportin Ndërkombëtar të Kukësit – Plani Kryesor i Ndërmjetëm: horizonti i planifikimit 2025 – Qershor 2020.

2. Kërkesat për kompaninë

Ofertuesi duhet të jetë i çertifikuar për operimin e Njësive të Shërbimeve të Trafikut Ajror për ofrimin e ATC (Kontrolli i Trafikut Ajror) dhe/ose AFIS (Shërbimet e Informacionit të Fluturimit në Aerodrom)

në një mjedis Kulle në përputhje me Rregulloren e BE-së 2017/373 nga Autoriteti i Aviacionit Civil perkates.

Ofertuesi duhet të ketë përvojë të mëparshme ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve konsulente.

Furnizuesi i shërbimeve duhet të jetë i çertifikuar në përputhje me Rregulloren e BE-së 2017/373.

3. Kërkesat specifike

Studimi i fizibilitetit për infrastrukturën e ofrimit të Shërbimeve të Trafikut Ajror (ATS) në Aeroportin e Kukësit përfshin identifikimin e strategjisë më të përshtatshme. Kjo përfshin përcaktimin e objektivave të dëshiruara, fushës së veprimit dhe horizontit kohor. Këto parakushte të rëndësishme për të gjithë hapat e mëtejshëm të projektit përmbledhen në një dokument të vetëm strategjik.

Përgatitja e një strategjie themelore mund të adresojë pyetje kyçe si:

- Cila qasje do të rezultojë në kursime të kostove?
- A mund të arrihet harmonizimi teknik i sistemeve të Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM)?
- A është e mundur të ofrohen shërbime të kontrollit të trafikut ajror në mënyrë efektive nga një qendër e vetme ku mund të integrohen kullat e së ardhmes?

Me një strategji të përshtatshme, shumë pyetje themelore mund të marrin përgjigje efektive. Furnizuesi i shërbimeve do të mbështesë Albcontrol në përzgjedhjen e zgjidhjes më të mirë nga opsionet e ndryshme për kullat e trafikut ajror.

Është kritike që të vlerësohet konfigurimi i duhur, duke marrë në konsideratë skenarët e mëposhtëm:

- Ndërtimi i një kulle betoni në Kukës;
- Blerja ose marrja me qira e një Kulle të Lëvizshme;
- Blerja e një Kulle të Largët (Remote Tower) për Aeroportin e Kukësit;
- Ndërtimi i një Qendre të Kontrollit të Largët (RTC) me mundësinë për të akomoduar disa aeroporte, nga pista të vogla AFIS deri te mundësia e shfrytëzimit si qendër emergjence për Kullën ATC të Aeroportit të Tiranës dhe asaj të Vlorës.

Një strategji e përshtatshme duhet të jetë e qëndrueshme për të ardhmen dhe e përshtatur me kushtet lokale, duke marrë parasysh kohën dhe vizionin për zhvillimin e aeroportit, me fokus kryesor në strategjinë për Aeroportin Ndërkombëtar të Kukësit.

Në përmbledhje, hartimi i kësaj strategjie duhet të realizohet në bashkëpunim të ngushtë me Albcontrol. Ky proces përfshin:

- Organizimin e një seminari strategjik në nivel të lartë për përcaktimin e fushës së veprimit, dhe
- Një diskutim në tryezë të rrumbullakët për identifikimin e aktorëve kryesorë.

Në këtë seminar do të duhet të marrin pjesë figura kyçe nga menaxhmenti i aeroportit dhe Albcontrol, si dhe përfaqësues nga AFISO/ATCO/ATSEP. Qëllimi kryesor është përcaktimi i fushës së veprimit për zgjidhjen e ardhshme që do të zbatohet në Shqipëri. Gjatë seminarit do të prezantohen për pjesëmarrësit mundësi të ndryshme për Zgjidhjet e Kullës, si: Kulla e betonit, Kulla e Lëvizshme, Kulla e Largët për një aeroport të vetëm, ose Qendra RTC për disa aeroporte. Gjithashtu, do të duhet të diskutohen dhe avantazhet e disavantazhet e secilës mundësi, duke përfshirë aspektet kyçe për zgjidhjet operationale dhe veçoritë e skenarëve operativë në lidhje me rastet e përdorimit të mundshëm nga Albcontrol.

Pas këtij seminari, do të duhet të organizohet një tryezë e zgjeruar për të identifikuar të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces ndryshimi, për të diskutuar qëndrimet e tyre ndaj zhvillimit dhe për të hartuar një analizë të nivelit të lartë dhe një strategji pasuese.

Ofruesi i shërbimeve do të prezantojë mundësi të ndryshme për konceptet e kullave dhe do të moderojë diskutimet, duke siguruar që të trajtohen të gjitha temat e rëndësishme operationale dhe që diskutimet të ndjekin një rrugë konstruktive. Si rezultat, pjesëmarrësit do të bien dakord për fushën e studimit të fizibilitetit dhe për rastet e përdorimit.

Studimi i fizibilitetit është dokumenti themelor që përfshin vlerësimin e ekspertëve të fushës mbi teknologjinë që mund të aplikohet në një aeroport. Si pjesë e këtij procesi, Ofruesi i Shërbimeve do të përdorë përvojën dhe metodat e tij për të analizuar se cilat zgjidhje janë më të përshtatshme dhe më të vlefshme dhe cila është mënyra më efikase për të ngritur një sistem operacional.

Studimi i fizibilitetit është një parakusht i rëndësishëm për çdo projekt të mirë strukturuar për kullat. Ai synon:

- Të thjeshtojë procesin e vendimmarrjes në lidhje me përshtatshmërinë e Zgjidhjeve për Kullat e trafikut ajror.
- Të identifikojë pengesat e mundshme që në fillim të projektit për të ulur rrezikun e dështimit.
- Të ofrojë një bazë konceptuale thelbësore dhe të përgatisë një tender të mundshëm duke përcaktuar kërkesat e përgjithshme.

Një studim fizibiliteti përfshin gjashtë hapa kryesorë:

1. **Rishikimi i dokumentacionit operacional dhe analiza e trafikut;**
2. **Inspektime në terren** për të vlerësuar kushtet lokale dhe objektivat specifike të klientit;
3. **Seminare për të diskutuar idetë dhe kërkesat e aktorëve kryesorë;**
4. **Dokumentimi në formën e një studimi** për të ofruar një bazë konceptuale për projektin;
5. **Analiza e Kostos dhe Përfitimit (CBA);**
6. **Përgatitja e kërkesave për tender.**

Dorëzimi përfundimtar do të jetë një dokument i vetëm që përfshin studimin e plotë të fizibilitetit.

Përmbajtja e studimit të fizibilitetit do të përfshijë:

- Vlerësimin e përgjithshëm të realizueshmërisë operationale dhe teknike;
- Zhvillimin e rasteve të ndryshme të përdorimit;
- Përpilimin e kërkesave operationale në nivel të lartë, metodologjinë, procesin dhe përkufizimin;
- Hartimin e një plani të përgjithshëm për zbatimin;
- Strukturën kryesore të koncepteve operationale;
- Indikimin e kërkesave bazë.

Analiza e Kostos dhe Përfitimit (CBA):

CBA është një qasje sistematike për të vlerësuar avantazhet dhe disavantazhet ekonomike të një Zgjidhjeje të mundshme për Kullën e trafikut ajror. Kjo analizë përfshin krahasimin e kostove totale të pritshme me përfitimet totale të pritshme. Qëllimi është të ndihmohet Albcontrol të marrë vendime të bazuara duke kuantifikuar kompromiset e përfshira.

Rasti i Biznesit (Business Case):

Rasti i Biznesit është thelbësor për të kuptuar realizueshmërinë e zgjidhjes së ardhshme për Kullën. Ky dokument përcakton:

- Investimet e nevojshme për suksesin e projektit;
- Kthimin nga Investimi (ROI) të bazuar në sinergjitë potenciale që vijnë nga zgjidhja e duhur për Kullën;
- Përputhshmërinë me kërkesat rregullative.

Rezultatet nga Rasti i Biznesit:

Pasi të përfundojë, ky dokument do të ofrojë:

- Mbikëqyrjen financiare të projektit;
- Sigurimin e përmbushjes së pikës së parashikuar të rentabilitetit;
- Monitorimin e afërt të kthimit të planifikuar nga investimi në krahasim me rezultatet aktuale.

Analiza e Kostos dhe Përfitimit përbëhet nga dy hapa kryesorë:

- **Sigurimi i modeleve CBA** për ndërtimin e një analize;
- **Dorëzimi i një raporti CBA** për përshtatjen e modeleve me mjedisin lokal.

Dorëzimi përfundimtar do të përfshijë modelet individuale të CBA-së, të cilët do të jenë pjesë e Studimit të Fizibilitetit.

Afati kohor

Paketat e punës të përmendura më sipër do të realizohen brenda një periudhe prej jo më shumë se 6 (gjashtë) muajsh.

Ekipi i Projektit

Ofruesi i shërbimit do të sigurojë një ekip me të paktën 3 anëtarë për ekzekutimin e kësaj pakete pune.

Përbërja dhe përvoja e ekipit:

1. **Menaxher Projekti:** Një anëtar me përvojë të mëparshme në Menaxhimin e Projekteve, me të paktën 15 vjet përvojë në aviacion.
2. **Ekspert Operacional ATC:** Një anëtar me përvojë të mëparshme në Operimet e ATC, me të paktën 15 vjet përvojë në kontrollin e trafikut ajror civil, duke mbuluar operimet në ACC, TWR si ATCO ose Mbikëqyrës turni.
3. **Inxhinier Industrial/Inxhinier Ndërtimi:** Një anëtar me përvojë të mëparshme në implementimin dhe optimizimin e zgjidhjeve për kullat në operacionet ekzistuese të aeroporteve.

4. Sasia e mallrave/shërbimeve të kërkuara

Nr. i Artikullit	Përshkrimi i shërbimit	Sasia
1.	Studimi i Fizibilitetit për Infrastrukturën e Ofrimit të Shërbimeve të Trafikut Ajror në Aeroportin e Kukësit, përfshirë: - Një raport mbi analizën e kostos/përfitimit; - Modelet për zhvillimin e analizës së kostos/përfitimit.	1 kopje origjinale dhe një kopje në formatin elektronik PDF

5. Afati i Dorëzimit të Shërbimit

Dorëzimi i Shërbimeve tek Autoriteti Kontraktues do të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **“Studimi i Fizibilitetit për Infrastrukturën e Trafikut Ajror në Aeroportin e Kukësit”,**

Afatet e ekzekutimit: 6 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Studimi i Fizibilitetit për Infrastrukturën e Trafikut Ajror në Aeroportin e Kukësit”.

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike.

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Sipas specifikimeve teknike.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022,2023,2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2022, 2023, 2024 të miratuara nga organet përkatëse shtetërore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata ku të kete realizuar shërbime të ngjashme, në një vlerë jo më vogël sa 39 % e fondit limit që prokurohet, të realizura gjatë tre viteve të fundit nga *nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes dhe të deklaruar në organet tatimore, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruar në organet tatimore, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001: 2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmerisë.

Çertifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

2.3.3 Ofertuesi duhet të dëshmojë dhe të paraqesë një dokument që vërteton se është i certifikuar për operimin e Njësive të Shërbimeve të Trafikut Ajror për ofrimin e ATC (Kontrolli i Trafikut Ajror) dhe/ose AFIS (Shërbimet e Informacionit të Fluturimit në Aerodrom) në një mjedis Kulle në përputhje me Rregulloren e BE-së 2017/373 nga Autoriteti i Aviacionit Civil përkatës.

2.3.4 Ofertuesi duhet të ketë gjithashtu në stafin e tij me kontratë të vlefshme pune staf me kualifikimet e mëposhtme dhe me një eksperiencë pune si më poshte:

- a) **Menaxher Projekti:** Një anëtar me përvojë të mëparshme në Menaxhimin e Projekteve, me të paktën 15 vjet përvojë në aviacion.
- b) **Ekspert Operacional ATC:** Një anëtar me përvojë të mëparshme në Operimet e ATC, me të paktën 15 vjet përvojë në kontrollin e trafikut ajror civil, duke mbuluar operimet në ACC, TWR si ATCO ose Mbikëqyrës turni.
- c) **Inxhinier Industrial/Inxhinier Ndërtimi:** Një anëtar me përvojë të mëparshme në implementimin dhe optimizimin e zgjidhjeve për kullat në operationet ekzistuese të aeroporteve.

Numri minimal i personelit që do të angazhohet për realizimin e procedurë duhet të jetë 3 persona. Për secilin anëtar të stafit kontraktori duhet të paraqesë:

1. CV
2. Kontratën e punës / bashkëpunimit
3. Çertifikatat/Diplomat përkatëse

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë A.K., përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
• Informacione për nënkontraktorin • Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____

etj.

